



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



LICENCË PËR OPERATORIN E SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SË ENERGJISË TERMIKE

DHËNË :

NDËRMARRJES “NGROHTORJA E QYTETIT” SH.A.

Numri i Licencës: ZRRE/Li_03/17

Prishtinë, 19 nëntor 2021

PËRMBAJTJA:

Neni 1 Qëllimi	3
Neni 2 Përkufizimet	3
Neni 3 Të drejtat dhe detyrimet	4
Neni 4 Llogaritë e Ndara për Aktivitetin e Operatorit të Shpërndarjes	5
Neni 5 Ndalimi i Ndër-subvencioneve	6
Neni 6 Ndalimi i Diskriminimit	6
Neni 7 Pajtueshmëria me Kodin e Shpërndarjes, Kodin e Matjes dhe me Rregullën për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji	7
Neni 8 Detyrimet e të Licencuarit Lidhur me Pajisjet Matëse	7
Neni 9 Funkionimi i Sistemit të Shpërndarjes	7
Neni 10 Qasja dhe Shfrytëzimi i Rrjetit të Shpërndarjes	8
Neni 11 Plani Zhvillimor	8
Neni 12 Blerja Ekonomike e Aseteve dhe Shërbimeve	9
Neni 13 Regjistrimi dhe Tjetërsimi i Aseteve Relevante të të Licencuarit	9
Neni 14 Furnizimi me Pajisje Matëse dhe Shërbimet e të Dhënave	10
Neni 15 Identifikimi dhe Parandalimi i Shfrytëzimit të Paautorizuar i Energjisë Termike	11
Neni 16 Standardet e Sigurisë dhe Planifikimit të Sistemit të Shpërndarjes	11
Neni 17 Standardet e Përgjithshme dhe Minimale të Përbushjes së aktiviteve të Operatorit të Shpërndarjes	12
Neni 18 Qasja në Tokë dhe /ose Ndërtesa	12
Neni 19 Kufizimi në Përdorimin e Informatës së Caktuar	13
Neni 20 Dhënia e Informatave Shfrytëzuesve tjerë të Sistemit të Shpërndarjes	13
Neni 21 Kodi i Sjelljes dhe Etikës së Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes	14
Neni 22 Informatat relevante për konsumatorë	14
Neni 23 Shëndeti dhe Siguria	14
Neni 24 Puna	15
Neni 25 Ndryshimi në Kontrollin e të Licencuarit	15
Neni 26 Obligimet e Shërbimit Publik	15
Neni 27 Sigurimi i Informacioneve ndaj ZRRE-së	15
Neni 28 Vazhdimi, Modifikimi, Pezullimi, Transferimi dhe Ndërprerja e Licencës	16
Neni 29 Taksat	16
Neni 30 Masat Administrative dhe Gjobat	16
Neni 31 Zgjidhja e Kontesteve	17
Neni 32 Hyrja në fuqi	17

Neni 1 Qëllimi

1. **Zyra e Rregullatorit për Energji – ZRRE** (në tekstin e mëtejshëm "Rregullatori"), në pajtim me autoritetin e dhënë Ligjin për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084), Nenin 18 dhe 19 të Ligjit për Energjinë (Ligji Nr. 05/L-081), Nenin 5 të Ligjit për Energji Termike (Ligji Nr. 05/L-052) dhe Rregullën për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë (Rregulla ZRRE/Nr.07/2017), nëpërmjet kësaj në seancën e datës 19 nëntor 2021 i vazhdon Ndërmarrjes **Ngrohtroja e Qytetit SH.A. Licencën për Operatorin e Sistemit të Shpërndarje së energjisë termike me numër licence ZRRE/Li_03/17, Adresa: Rezina, Gjakovë, Republika e Kosovës** (në tekstin e mëtejshëm "i Licencuari").

Neni 2 Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë licencë do të kenë kuptimin si në vijim:
 - a) **"Anëtar"** – marrëdhënia e drejtpërdrejt ose indirekte me të Licencuarin, çdo ndërmarrje Aksionare apo vartës i të Licencuarit, apo ndonjë vartës të një ndërmarrje aksionare e të Licencuarit, e themeluar sipas legjislacionit në fuqi.
 - b) **"Pika furnizuese"** – nënstacioni termik prej të cilit fluidi-bartës i energjisë termike, eventualisht edhe uji i ngrohtë sanitarë, i dërgohen konsumatorit të fundit dhe në të cilën bëhet matja e furnizimit me pajisje matëse përkatëse.
 - c) **"Tubacioni i drejtpërdrejt i energjisë termike"** – tubacion i ngrohjes së përqendruar që lidh drejtpërdrejt objektet e prodhuesit me atë të konsumatorit.
 - d) **"Konsumator i fundit"** – shpenzuesi i energjisë termike për përdorim vetanak.
 - e) **"Vit Raportues"** – periudha prej 15 Tetor të vitit aktual deri me 14 Tetor të vitit të ardhshëm.
 - f) **"Rrjeti i shpërndarjes së energjisë termike"** – sistemi i tubacioneve, që transportojnë dhe shpërndajnë energjinë termike nga prodhuesi deri tek nënstacionet termike (prej vendit të matjes së energjisë termike të pranuar, deri tek vendi i matjes së energjisë termike për furnizim respektivisht nënstacionet termike dhe njehsorëve të energjisë termike).
 - g) **"Sistemi i energjisë termike"** – sistemi teknik i përbërë nga stabilimente dhe pajisje për prodhimin e energjisë termike, nga instalimet e brendshme dhe të jashtme, që mundësojnë furnizimin me energji termike dhe mund të jetë i pavarur, i mbyllur, ose sistem qendror i energjisë termike.

- h) **"Ndërmarrje e energjisë termike "** – subjekti që përmbush një ose më shumë aktivitete të prodhimit, shpërndarjes dhe furnizimit të energjisë termike, bazuar në licencën e dhënë, ashtu si dhe prodhuesit e energjisë termike që janë kyçur në sistemin e energjisë termike të përjashtuar nga licenca, siç përcaktohet në Ligjin për Rregullatorin e Energjisë.
 - i) **"Legjislacion"** - Ligji për Energjinë (Ligji Nr. 05/L-081), Ligji për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-84), Ligjin për Energjinë Elektrike (Ligji Nr. 05/L-085)), Ligji për Energji Termike (Ligji Nr. 05/L-052) si dhe çdo legjislacion tjetër primar apo sekondar që rregullon sektorin e energjisë.
 - j) **"Kodi i shpërndarjes"** – përmbledhje e rregullave teknike dhe procedurave për operimin, mirëmbajtjen, planifikimin dhe zhvillimin e sistemit të shpërndarjes, si dhe kyçjen në sistemin e shpërndarjes së energjisë termike
 - k) **"Kod i Matjes"** – përmbledhje e rregullave dhe procedurave që përcaktojnë mënyrën e leximit të njehsorëve (matësve), llogaritjes së energjisë termike të shpenzuar, faturimit dhe arkëtimit në sektorin e energjisë termike .
 - l) **"Pajisje matëse"** – instrumenti i regjistruar në regjistrin për certifikimin e pajisjeve matëse, të cilat përdoren në procesin e prodhimit dhe të furnizimit të energjisë termike.
 - m) **"Furnizuesi publik"** – ndërmarrja e energjisë termike e licencuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji për të kryer veprimtarinë e furnizimit publik.
 - n) **"Furnizues"** – ndërmarrje e energjisë e licencuar për të kryer veprimtari të furnizimit me energji termike për ngrohje.
 - o) **Furnizimi publik** – furnizimi i konsumatorëve fundorë me energji termike me tarifa të rregulluara në pajtim me Ligjin për energjinë termike.
 - p) **"Furnizim"** – dërgimi, shitja ose rishitja e energjisë termike për ngrohje te konsumatorët.
 - q) **"Vartës"** – çdo kompani në pronësi apo e kontrolluar nga një kompani tjetër, e që definohet sipas legjislacionit në fuqi në Kosovë.
2. Shprehjet tjera të përdorura në këtë Licencë do të kenë të njëjtin kuptim si termet e përdorura në Legjislacionin në fuqi.

Neni 3 Të drejtat dhe detyrimet

1. I Licencuari do të veprojë në pajtueshmëri me Nenet dhe kushtet e përcaktuara në këtë licencë, Ligjin për Energjinë Termike dhe legjislacionin tjetër në fuqi.
2. I licencuari do të veprojë si vijon:
 - 2.1 kryej në mënyrë efektive obligimet e përcaktuara me këtë Licencë;
 - 2.2 operojë në mënyrë efikase, ekonomike dhe të koordinuar me sistemin e shpërndarjes së energjisë termike;
 - 2.3 nxisë konkurrencën efektive për gjenerim, furnizim, si dhe blerje dhe shitje të energjisë termike, duke mundësuar qasjen dhe shfrytëzimin e sistemit në mënyrë jo-diskriminuese dhe transparente.
3. I Licencuari për territorin e caktuar dhe të mbuluar nga rrjeti i shpërndarjes do të kryej shërbimet si në vijim:
 - 3.1 menaxhojë rrjetin e shpërndarjes;
 - 3.2 mirëmbajë rrjetin dhe objektet në përputhje me kërkesat teknike;
 - 3.3 harmonizojë projektet e veta me projektet për zhvillim ekonomik;
 - 3.4 parashikojë kërkesat në territorin të cilin e mbulon;
 - 3.5 bartë në mënyrë të vazhdueshme dhe të sigurt energjinë termike përmes rrjetit të shpërndarjes;
 - 3.6 informojë shfrytëzuesit e rrjetit me informata që ju nevojiten për qasje efikase në rrjet; dhe
 - 3.7 shërbime të tjera përkatëse.
4. Territori që mbulohet nga kjo licencë është territori i Komunës së Gjakovës.

Neni 4

Llogaritë e Ndara për Aktivitetin e Operatorit të Shpërndarjes

1. I Licencuari do të përgatisë dhe dorëzojë në ZRRE Pasqyrat Financiare Vjetore të audituara nga auditori i pavarur në përputhje me Ligjet vendore në fuqi dhe Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, brenda afateve të përcaktuara me ligjet në fuqi për raportimin financiar.
2. I Licencuari do të përgatisë Pasqyrat Rregullative Vjetore në përputhje me Udhëzimin për Raportimin Rregullativ të Ndërmarrjeve të Energjisë Termike , nxjerrë nga ZRRE-ja dhe do

t'i dorëzohë ZRRE-së një kopje të këtyre Pasqyrave brenda tre (3) muajve pas përfundimit të vitit raportues.

3. I Licencuari në kontabilitetin e vet të brendshëm do të mbajë kontabilitetin (llogari) për aktivitetin e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes në tërësi, ndaras nga aktivitetet tjera, dhe duhet t'i dorëzohet ZRRE-së në formën dhe datën e specifikuar nga ZRRE-ja. Kontabiliteti Rregullativ do të mbahet në përputhje me Udhëzimet për Raportimin Rregullativ të Ndërmarrjeve të Energjisë Termike, që ndër të tjera mund të specifikojnë:
 - 3.1. formën e Pasqyrave / deklaratave rregullative të kontabilitetit, duke përfshirë, por duke mos u kufizuar vetëm në Pasqyrën e të Ardhurave (fitimit dhe humbjes), bilancin e gjendjes, Pasqyrat e pranuar të fitimeve dhe humbjeve, Pasqyrën e rrjedhjes së parave të gatshme dhe bilancin e energjisë termike (ngrohjes), si dhe deklaratat për shumat e të ardhurave vjetore, kostot, asetet, borxhet, rezervat ose furnizimet të cilat janë faturuar nga një aktivitet tjetër, ose janë përcaktuar nga alokimi ose shpërndarja midis aktivitetit të konsoliduar të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes dhe ndonjë aktiviteti tjetër.
 - 3.2. natyrën dhe përmbajtjen e Pasqyrave / deklaratave rregullative të kontabilitetit, duke përfshirë informacione mbi lloje të specifikuara të të ardhurave vjetore, shpenzimeve, aseteve ose borxheve dhe informacione mbi të ardhurat vjetore, kostot, asetet, shpenzimet dhe borxhet nga aktivitetet e specifikuara.
 - 3.3. parimet dhe politikat e kontabilitetit rregullativ (duke përfshirë bazat për alokimin e shpenzimeve).
4. Në lidhje me pasqyrat / deklaratat e kontabilitetit rregullativ për sa i përket vitit financiar, i Licencuari nuk do të ndryshojë bazat e tarifimit, shpërndarjes ose alokimit që janë përdorur në vitin financiar paraprak, përveç nëse ZRRE-ja ka nxjerrë më parë udhëzime për qëllimet e këtij Neni ose nëse ZRRE-ja jep paraprakisht aprovimin me shkrim për ndryshimin e këtyre bazave.
5. I Licencuari do veproj në pajtueshmëri me çdo udhëzim të nxjerrë nga ZRRE-ja dhe legjislacioni në fuqi.

Neni 5

Ndalimi i Ndër-subvencioneve

I Licencuari do të parandalojë ose evitojë që aktiviteti i shpërndarjes të japë apo të marrë ndonjë ndër-subvencion (direkt apo të tërthortë) prej ndonjë aktiviteti tjetër të Licencuarit ose nga ndonjë Vartësi (ortaku) apo anëtar ose ndonjë personi tjetër.

Neni 6

Ndalimi i Diskriminimit

Gjatë përcaktimit të çmimeve që do t'ju ngarkohen shfrytëzuesve të sistemit të Licencuarit, i Licencuari nuk do të ketë ndonjë preferencë për ndonjë shfrytëzues ose kategori të shfrytëzuesve dhe nuk do ushtroj diskriminim të pa arsyeshem ndaj çfarëdo shfrytëzuesi ose kategorie të shfrytëzuesve, dhe nuk do të imponoj kushte të padrejta dhe të paarsyeshme për kyçjen dhe shfrytëzimin e sistemit.

Neni 7

Pajtueshmëria me Kodin e Shpërndarjes, Kodin e Matjes dhe me Rregullën për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji

1. I Licencuari do të veproj në përputhje me dispozitat e Kodit të Shpërndarjes, Kodin e Matjes, dhe Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji, si dhe legjislacionin tjetër në fuqi.
2. I Licencuari mund të kërkojë derogim (shtyrje e afatit) në zbatimin e atyre dispozitave që nuk është e mundur të zbatohen sipas paragrafit 1 të këtij Neni. ZRRE-ja pas shqyrtimit të kërkesës nga i Licencuari mund të lejojë apo refuzojë derogimin (shtyrjen e afatit) të zbatimit.

Neni 8

Detyrimet e të Licencuarit Lidhur me Pajisjet Matëse

1. I Licencuari do të veprojë në pajtim me Ligjin për Energjinë termike dhe Kodet e Shpërndarjes e të Matjes, si dhe legjislacionin sekondar të lëshuar nga ZRRE dhe nga Ministria përgjegjëse për energji.
2. I licencuari do të bëjë instalimin, operimin, mirëmbajtjen e pajisjeve matëse, në pajtim me Ligjin për Energjinë Termike dhe Kodet e Shpërndarjes e të Matjes, si dhe legjislacionin sekondar të lëshuar nga ZRRE dhe nga Ministria përgjegjëse për energji.

Neni 9

Funksionimi i Sistemit të Shpërndarjes

1. I Licencuari do të kryejë operim efikas, ekonomik dhe të koordinuar të sistemit të shpërndarjes, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
2. I Licencuari është i obliguar të ofrojë kushtet dhe procedurat për kyçje dhe përdorimin e sistemit të tij, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe Rregullën për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji. Për çdo kontest që del nga kyçja apo përdorimi i sistemit të Shpërndarjes, do të zbatohet Rregullën për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë, të nxjerrë nga ZRRE-ja.
3. I licencuari do të lejojë kyçjen e konsumatorëve dhe shfrytëzuesve tjerë të Sistemit të Shpërndarjes së energjisë termike ipas kushteve të kyçjes dhe procedurave të përshkruara në Ligjin për Energjinë Termike , rregullat dhe Kodet tjera në fuqi.

4. I Licencuari do t'i jap prioritet kyçjes së prodhuesve të energjisë termike në Sistemin e Shpërndarjes dhe kyçjes së çdo prodhuesi që prodhon energji termike prej burimeve të ripërtëritshme të energjisë dhe kogjenerimit, në përputhje me Ligjin për Energjinë Termike .
5. I Licencuari do të publikojë në faqen zyrtare elektronike të tij Metodologjinë Tarifore për kyçje dhe shfrytëzim të Sistemit të Shpërndarjes, të aprovuar nga ZRRE-ja, si dhe kodet, informacionet dhe të dhënat tjera siç kërkohen nga legjislacioni në fuqi.

Neni 10

Qasja dhe Shfrytëzimi i Rrjetit të Shpërndarjes

1. I licencuari do të lejojë që prodhuesit, furnizuesit dhe konsumatorët e kualifikuar të kenë qasje dhe të shfrytëzojnë Rrjetin e Shpërndarjes duke u bazuar në Ligjin për Energjinë Termike dhe rregullat miratuara nga ZRRE-së.
2. I Licencuari mund të refuzojë qasjen (kyçjen) në Rrjetin e Shpërndarjes në përputhje me Nenin 29 të Ligjit për Energjinë Termike.
3. Sipas Nenit 29 të Ligjit për Energji Termike, nëse nuk lejohet qasje në Rrjetin e Shpërndarjes për konsumatorët e kualifikuar ose prodhuesit që dëshirojnë të lidhin kontrata me Konsumatorë të Kualifikuar, atëherë ata mund të paraqesin kërkesë (aplikojnë) në ZRRE për lejimin e ndërtimit të tubacionit të drejtpërdrejtë të ngrohjes.

Neni 11

Plani Zhvillimor

1. Në përputhje me Nenin 15 të Ligjit për Energjinë Termike dhe legjislacionin tjetër në fuqi, i Licencuari do të hartojë dhe publikojë Planet Zhvillimore afatshkurta dhe afatgjata për zhvillimin e rrjetit të shpërndarjes dhe t'i koordinojë planet e tilla me Ministrinë përkatëse dhe me institucionet komunale përkatëse. I Licencuari do t'iu lë në dispozicion ndërmarrjeve gjeneruese të energjisë termike si dhe furnizuesit(ve) planet dhe analizat e veta studimore.
2. Në Përputhje me Nenin 10 të Ligjit për Energjinë, Nenin 15 të Ligjit për Energjinë Termike dhe Nenin 12 të Rregullës për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë, i Licencuari do të përgatisë Planin Zhvillimor afatshkurtër (3 vjeçar) dhe afatgjatë (10 vjeçar) të Sistemit të Shpërndarjes, dhe të dorëzojë në ZRRE për aprovim.
3. I Licencuari do të rishikojë planin zhvillimor çdo vit, në mënyrë që informacioni i paraqitur në planin zhvillimor, të vazhdojnë të jenë i saktë në të gjithë aspektet materiale. Propozimet eventuale për plotësimin apo ndryshimin e Planit Zhvillimor do t'i dorëzojë ZRRE-së për aprovim.

4. I Licencuari do të jetë përgjegjës për menaxhimin dhe mirëmbajtjen e rrjetit të shpërndarjes si dhe mirëmbajtjen e pajisjeve dhe vendndodhjes së tyre në përputhje me kërkesat teknike të përcaktuara në Kodet në fuqi dhe në pajtim me Ligjin për Energjinë Termike.
5. I Licencuari do të jetë përgjegjës për zgjerimin dhe rindërtimin e rrjetit të shpërndarjes së energjisë termike për ngrohje që nga pika e furnizimit deri te gjeneruesi i energjisë termike, në pajtim me Ligjin për Energjinë Termike.

Neni 12

Blerja Ekonomike e Aseteve dhe Shërbimeve

1. I Licencuari do të kontraktojë dhe sigurojë asetet dhe shërbimet që janë të nevojshme për t'i mundësuar të Licencuarit që të kryej detyrimin e tij sipas Kodeve në fuqi. Kontraktimet e tilla do të bëhen në përputhje me Ligjin për Prokurimin Publik në Kosovë dhe legjislacionin tjetër relevant në fuqi.
2. Gjatë kontraktimit për sigurimin e asetëve dhe shërbimeve sipas paragrafit 1 të këtij Neni, i Licencuari do të blejë ose do të sigurojë në ndonjë formë tjetër ato asete dhe shërbime nga burimet më ekonomike që ka në dispozicion.
3. Duke marrë parasysh burimet më ekonomike që ka në dispozicion, i Licencuari duhet të ketë parasysh sasinë, natyrën, shumëllojshmërinë, numrin dhe sigurinë e asetëve të tilla dhe shërbimeve që në atë kohë kanë qenë në dispozicion për blerje ose për përvetësim tjetër, dhe sipas nevojave të tij që t'i mundësojë atij që t'i kryej obligimet e tija sipas kësaj licence, Kodit të Shpërndarjes dhe Legjislacionit tjetër në fuqi.

Neni 13

Regjistrimi dhe Tjetërsimi i Aseteve Relevante të të Licencuarit

1. I Licencuari do të përgatisë dhe do të mirëmbajë një regjistër për të gjithë asetet relevante dhe do t'ia dorëzojë ZRRE-së këtë regjistër, jo më vonë se 31 Janar të çdo viti.
2. I Licencuari nuk do të shesë apo heqë dorë nga kontrolli funksional mbi ndonjë aset relevant, nëse kjo do të ndikonte në aftësinë e tij për t'i kryer obligimet e tija apo nëse aset i ka vlerën e zëvendësimit mbi njëqindmijë Euro (100,000.00 €).
3. Në rast kur i Licencuari dëshiron të shesë asete apo pasuri tjera që përdoren në ushtrimin e aktivitetit të licencuar, ku vlera e tyre e tejkalon shumë njëqind mijë euro (100,000.00€), i Licencuari është i obliguar që ta njoftojë ZRRE-në me shkrim dhe kërkon miratimin e ZRRE-së. I Licencuari mund ta bëjë tjetërsimin e ndonjë asemi të tillë vetëm pas miratimit me shkrim nga ZRRE-ja.
4. E njëjta si në paragrafin 2 të këtij Neni aplikohet edhe për dhënien në shfrytëzim të asetëve ose burimeve (resurseve) të tjera që përdoren për të kryer aktivitetin e licencuar.

5. Në këtë Nen:

"Tjetërsimi" - çdo shitje, transferim, dhurim, dhënie me qira, hua, hipotekë, ngarkim, kufizim mbi shfrytëzimin (qoftë ky fizik ose ligjor) ose ndonjë pagesë tjetër, si dhe lejim i ndonjë pagese ndaj një aktiviteti tjetër të të Licencuarit dhe/ose një pale të tretë.

"Aset relevant" - çdo pajisje dhe çdo pasuri e luajtshme ose e paluajtshme e përdorur nga i Licencuari për ushtrimin e aktivitetit të shpërndarjes së energjisë termike, përfshirë çdo interes ligjor apo të dobishëm për ndonjë tokë apo objekt dhe çdo pronësi intelektuale.

Neni 14

Furnizimi me Pajisje Matëse dhe Shërbimet e të Dhënave

1. I Licencuari, në përputhje me nenet 30 dhe 35 të Ligjit për Energjinë Termike, nenet 21 dhe 22 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji, Kodin e Shpërndarjes dhe Kodin e Matjes, si dhe duke marrë parasysh kërkesat e konsumatorëve, dhe furnizuesit(ve), do të siguroj këto shërbime:
 - 1.1 furnizimin me Pajisje Matëse;
 - 1.2 instalimin, matjen, testimin, riparimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve matëse;
 - 1.3 shërbimet për grumbullimin e të dhënave;
 - 1.4 mbledhjen përpunimin dhe transferin e të dhënave.
2. I Licencuari mund t'ia besoj leximin e njehsorëve furnizuesit ose kontraktorëve të tjerë. Në këtë rast, i Licencuari duhet të sigurohet se entiteti i kontraktuar për lexim të njehsorëve duhet të performoj lexim të rregullt dhe të saktë të njehsorëve, në pajtim me Kodin e Matjes.
3. Rregullatori mund të kërkoj nga i Licencuari të grumbulloj dhe mbaj informata, të dhëna dhe dokumente në përputhje me Nenin 18 të Rregullës për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë

Në këtë Nen:

"Shërbimet e të dhënave" - mbledhja e të dhënave, procesimi i të dhënave, shërbimet e grumbullimit të të dhënave dhe furnizimi me të dhëna;

"Transferi i të dhënave" - transferimin e të dhënave të papërpunuara dhe të dhënave të përpunuara mbi matjet tek ndërmarrje tjera të licencuara për energji, siç kërkohen për llogaritjet përfundimtare dhe për qëllime të faturimit;

"Përpunimi i të dhënave" - shërbime që përmbajnë shqyrtimin, vlefshmërinë, vlerësimin e të dhënave nga leximi i njehsorit në lidhje me konsumimin e energjisë termike.

Neni 15

Identifikimi dhe Parandalimi i Shfrytëzimit të Paautorizuar i Energjisë Termike

1. I Licencuari do të ndërmarrë të gjitha masat e arsyeshme me qëllim të identifikimit dhe parandalimit të shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë termike, dëmtimi të ndonjë pajisje apo njehsori dhe shkeljeve të tjera të përcaktuara në dispozitat e kapitullit VII: "Shfrytëzimi i paautorizuar i energjisë" të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji.
2. I Licencuari është i obliguar hartoj dhe të zbatoj Procedurën për identifikimin dhe parandalimin e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë termike, dhe do të ndërmerr masat parandaluese për të ndaluar shfrytëzimin e paautorizuar, si dhe për të llogaritur shfrytëzimin paautorizuar respektivisht kompensimin e humbjeve të shkaktuara nga shfrytëzimi i paautorizuar me qëllim për të mbrojtur të hyrat e OSSH-së.
3. Me kërkesë të Licencuarit apo të Rregullatorit Procedura për identifikimin dhe parandalimin e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë termike mund të ndërrohet (plotësohet) kohë pas kohe, por ndryshimet (plotësimet) e tilla duhet të aprovohen nga Rregullatori.

Neni 16

Standardet e Sigurisë dhe Planifikimit të Sistemit të Shpërndarjes

1. I Licencuari brenda dymbëdhjetë (12) muajsh nga data e aprovimit të modifikimit të kësaj licence, do të hartojë Standardet e Sigurisë dhe Planifikimit të Sistemit të Shpërndarjes dhe do t'i dërgojë në ZRRE për aprovim.
2. I Licencuari do të jetë përgjegjës për funksionimin, sigurimin e mirëmbajtjes së Sistemit të Shpërndarjes, dhe nëse është e nevojshme, edhe zhvillimin e tij në përputhje me Standardet e Sigurisë dhe Planifikimit të Sistemit të Shpërndarjes si dhe me standarde të tjerë të planifikimit dhe operimit të cilat i Licencuari mund t'i zbatojë, pas aprovimit nga ZRRE.
3. I Licencuari do të shqyrtojë kohë pas kohe zbatimin e Standardeve të Sigurisë dhe Planifikimit të Sistemit të Shpërndarjes dhe do të dorëzojë në ZRRE:
 - 3.1. një raport të rezultateve të këtij shqyrtimi; dhe
 - 3.2. propozimin për amendamentim eventual të Standardeve të Sigurisë dhe Planifikimit të Sistemit të Shpërndarjes.
4. ZRRE-ja mund të nxjerrë udhëzime me të cilat i kërkon të Licencuarit të rishikojë Standardet e Sigurisë dhe Planifikimit të Sistemit të Shpërndarjes, në atë mënyrë që është specifikuar në udhëzime.

5. I Licencuari do të publikojë në faqen elektronike zyrtare të tij Standardet e Sigurisë dhe Planifikimit të Sistemit të Shpërndarjes.
6. I Licencuari mund të kërkojë derogim (shtyrje afati) në zbatimin e disa dispozitave të Standardeve të Sigurisë dhe Planifikimit të Sistemit të Shpërndarjes. ZRRE-ja pas shqyrtimit të kërkesës së të Licencuarit mund të lejojë ose refuzojë derogimin (shtyrjen e afatit) të zbatimit.

Neni 17

Standardet e Përgjithshme dhe Minimale të Përmbushjes së aktiviteteve të Operatorit të Shpërndarjes

1. I Licencuari do të veproj në pajtueshmëri me të gjitha standardet e përgjithshme dhe minimale të përmbushjes (Standardet e Cilësisë së Furnizimit dhe Shërbimit të Energjisë Termike) që do të nxjerrën nga ZRRE dhe azhurnimet eventuale të tyre.
2. Standardet e tilla të përmbushjes do të:
 - 2.1. identifikojnë standardet e performancës së përgjithshme të cilat do të jetë i obliguar ti përmbush;
 - 2.2. paraqesë standardet minimale dhe kualitetin e shërbimeve në lidhje me çështjet specifike në të cilat do të jetë i obliguar t'i përmbushë kohë pas kohe; dhe
 - 2.3. specifikojë kompensimet financiare që do t'u paguhen konsumatorëve në rast kur standardet minimale nuk janë në përputhje me nën-paragrafin 2.2 të këtij Neni.
3. I Licencuari do të zbatoj standardet e aprovuara dhe do t'i propozojë ZRRE-së për aprovim procedurat e monitorimit të përmbushjes së standardeve të cilësisë dhe furnizimit dhe shërbimit. I Licencuari do të veprojë në pajtueshmëri me procedurat e aprovuara.
4. I Licencuari do të rishqyrtojë dhe nëse kërkohet, do të propozojë ndryshime në standardet e aprovuara.
5. I Licencuari do t'i sigurojë ZRRE-së jo më vonë se 31 Mars të çdo viti kalendarik raport mbi ushtrimin e veprimtarisë lidhur me standardet që duhet përmbushur. Ky raport do të përfshijë informata dhe analiza lidhur me përmbushjen e standardeve sipas këtij Neni.
6. I Licencuari deri me 31 Mars të çdo viti kalendarik do të publikojë statistikën ashtu siç kërkohet nga ZRRE-ja lidhur me përmbushjen ose mos-përmbushjen e standardeve të përcaktuara sipas këtij Neni.

Neni 18

Qasja në Tokë dhe /ose Ndërtesa

1. I Licencuari do të zbatojë Kodin për Qasje në Tokë dhe Ndërtesa i cili përcakton parimet dhe procedurat që do të zbatojë çdo person që vepron në emër të të licencuarit dhe që kërkon qasje në tokë dhe/ose ndërtesa për kryerjen e aktivitetit të licencuar.
2. Kodi për qasje në tokë dhe ndërtesa do të përfshijë procedurat për të siguruar që personi që kërkon qasje në tokën dhe/ose ndërtesën në emër të të Licencuarit:
 - 2.1. posedon aftësitë e nevojshme për të kryer detyrat e kërkuara;
 - 2.2. mund të identifikohet nga publiku; dhe
 - 2.3. janë persona të autorizuar për të vizituar dhe hyrë në toka apo ndërtesa.
3. I Licencuari do të rishqyrtojë kohë pak kohe Kodin për qasje në tokë dhe ndërtesa dhe çdo ndryshim i këtij Kodi do t'i nënshtrohet aprovimit të ZRRE-së.

Neni 19

Kufizimi në Përdorimin e Informatës së Caktuar

1. I Licencuari, aty ku është e domosdoshme për kryerjen e aktiviteteve të licencuara, do të zbulojë çdo informacion, përveç atyre informatave konfidenciale, që i mban dhe/ose i ka siguruar gjatë kryerjes së funksioneve të veta si Operator i Sistemit të Shpërndarjes. Pavarësisht nga kjo i Licencuari do t'i ofroj çdo informatë ZRRE-së që ajo mund t'i kërkojë në kryerjen e obligimeve që i janë dhënë me Legjislacionin në fuqi dhe Nenin 22 të kësaj Licence.
2. I Licencuari do të sigurojë që çdo dokument që përmban informacione konfidenciale (të fshehta), duhet ta bëjë identifikimin e qartë të informacionin si konfidencial (ta shënjojë si informatë konfidenciale).
3. I Licencuari do të marrë masat e parapara për të parandaluar zbulimin e informacioneve konfidenciale nga çdo person, dhe këto informata nuk mund të përdoren apo zbulohen për ndonjë qëllim tjetër nga ai që është dhënë sipas dispozitave përkatëse të ligjeve në fuqi.

Neni 20

Dhënia e Informatave Shfrytëzuesve tjerë të Sistemit të Shpërndarjes

1. Në mënyrë që të sigurojë funksionim efikas dhe zhvillim të koordinuar të sistemit të energjisë termike i Licencuari do t'i dërgojë çdo informatë të domosdoshme shfrytëzuesve (operatorëve) tjerë të Sistemit të Shpërndarjes, në atë mënyrë dhe në atë kohë që me arsye mund të jetë kërkuar nga këta operatorë.

2. Në rast të paraqitjes së ndonjë kontesti në mes të Licencuarit dhe ndonjë pale tjetër, i Licencuari do të procedojë në përputhje me Rregullën për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë, të nxjerrë nga ZRRE-ja.

Neni 21

Kodi i Sjelljes dhe Etikës së Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes

1. Kodi i Sjelljes dhe Etikës i Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, i aprovuar nga ZRRE-ja do të zbatohet ndaj të gjithë punonjësve të Licencuarit. Ky Kod do të mbulojë detyrimet lidhur me konfidencialitetin e informatave, konfliktet e interesave dhe obligime tjera.
2. I Licencuari do të publikoj Kodin e Sjelljes dhe Etikës në faqen zyrtare elektronike të tij.

Neni 22

Informatat relevante për konsumatorë

1. I Licencuari do të siguroj informata për furnizuesin me qëllim të informimit të konsumatorëve lidhur me sasinë e energjisë termike që është regjistruar si e shpenzuar nga ai konsumator sipas njehsorit (matësit) përmes të cilit konsumatori është furnizuar.
2. I Licencuari do t'i mbajë të informuar furnizuesin me qëllim të informimit të konsumatorëve lidhur me riparimet dhe mirëmbajtjet e planifikuara në rrjet që eventualisht mund të jen shkas për ndërprerje të furnizimit me energji termike.
3. I Licencuari po ashtu do të siguroj çfarëdo informate tjetër që konsiderohet e rëndësishme për furnizimin e konsumatorëve me energji termike.

Neni 23

Shëndeti dhe Siguria

1. I Licencuari do të ndërmarrë të gjithë masat e nevojshme për të mbrojtur personat nga lëndimet që mund t'iu shkaktohen atyre nga ana e të Licencuarit gjatë kryerjes së aktivitetit të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
2. I Licencuari në përputhje me legjislacionin në fuqi, do të kryej kontroll (auditim) teknik dhe të sigurisë të sistemit të shpërndarjes, dhe rezultatet e një kontrolli të tillë do ti dërgoi në ZRRE, sa herë që kjo kërkohet nga ZRRE-ja.

Neni 24
Puna

I Licencuari lidhur me marrëdhënien në punë dhe sigurinë në punë do të veprojë në pajtim me legjislacionin në fuqi në Kosovë.

Neni 25
Ndryshimi në Kontrollin e të Licencuarit

1. I Licencuari do të njoftojë ZRRE-në për ndonjë ndryshim që pritet në kontroll të të Licencuarit së paku gjashtëdhjetë (60) ditë paraprakisht. Ndryshimi në kontroll nuk do të jetë efektiv deri sa ZRRE-ja nuk e aprovon atë.
2. I Licencuari do të njoftojë ZRRE-në për ndonjë ndryshim të Strukturës Organizative të të Licencuarit. Njoftimi i tillë do t'i bëhet ZRRE-së jo më vonë se tre (3) ditë nga data e çdo ndryshimi të tillë.

Neni 26
Obligimet e Shërbimit Publik

I Licencuari do të kryej çdo obligim të shërbimeve publike që mund t'i vendoset nga ZRRE-ja, sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 27
Sigurimi i Informacioneve ndaj ZRRE-së

1. I Licencuari do t'i dorëzojë ZRRE-së informacione dhe raporte në mënyrën dhe në afatet që ZRRE-ja mund t'i konsiderojë të nevojshme.
2. Nëse i Licencuari, në përputhje me Rregullën për Informatat konfidenciale kërkon që një informacion i caktuar të konsiderohet si konfidencial atëherë është obligim i tij që të shënjojë atë informacion si konfidencial dhe të arsyetojë kërkesën e tij tek ZRRE-ja. ZRRE do të shqyrtojë kërkesën e tillë në pajtim me Rregullën për Informatat Konfidenciale.
3. ZRRE-ja ka të drejtë të kërkojë nga i licencuari çdo informatë konfidenciale, të nevojshme për përmbushjen e funksioneve dhe detyrave të saj, në pajtim me Nenin 12 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë.
4. I Licencuari duhet të përcaktoj një anëtarë të personelit i cili do të shërbej si pikë kontakti apo referimi për ndërlidhje me ZRRE; ky anëtarë pra do të shërbej si përgjegjës për çështje rregullative.

5. I Licencuari duhet t'i dërgojë ZRRE-së detajet për çdo ndryshim në informata që janë dërguar gjatë aplikimit për këtë licencë.

Në këtë Nen:

"Informacion" - materiali që në çdo formë dhe pa asnjë kufizim do të përfshijë çdo kontratë, libër, dokument, regjistër, llogari kontabël (statutore ose tjetër), vlerësim, kthim ose raport të çdo përshkrimi dhe çdo shpjegim (gojor ose me shkrim) në lidhje me këto informacione që mund të jenë kërkuar nga ZRRE-ja.

Neni 28

Vazhdimi, Modifikimi, Pezullimi, Transferimi dhe Ndërprerja e Licencës

1. ZRRE-ja mund të vazhdojë, modifikojë, pezullojë, dhe ndërpresë këtë licencë në përputhje me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë dhe Rregullën për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë.
2. ZRRE-ja mund të transferojë këtë licencë në përputhje me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë, Rregullën për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë dhe legjislacionin tjetër në fuqi, por duke siguruar që obligimet e licencës mund të kryhen nga i licencuari tjetër dhe nëse konsumatorët nuk do të dëmtohen për shkak të një transferimi të tillë.

Neni 29

Taksat

I Licencuari do t'i paguajë ZRRE-së çdo taksë të përcaktuar sipas Rregullës për Taksat, të nxjerrë nga ZRRE-ja.

Neni 30

Masat Administrative dhe Gjobat

1. Në rast shkeljeje të dispozitave të legjislacionit në fuqi, përfshirë Rregullat e nxjerra nga ZRRE-ja apo nenet dhe kushtet e kësaj licence apo instruksioneve dhënë të Licencuarit nga ana e ZRRE-së, ZRRE-ja ka kompetenca t'i vendosë të Licencuarit Masa Administrative dhe Gjoba, në përputhje me Nenin 57 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë dhe Rregullën për Masat Administrative dhe Gjobat.
2. Masat administrative dhe gjobat mund t'i vendosen ndërmarrjes si subjekt juridik si dhe personave përgjegjës të ndërmarrjes.
3. Shuma e gjobës do të vlerësohet në pajtim me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë dhe Rregullën për Masat Administrative dhe Gjobat.

Neni 31
Zgjidhja e Kontesteve

1. Çdo kontest që paraqitet apo është i lidhur me aktivitetet e licencuara do të zgjidhet në përputhje me Rregullën për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë, të nxjerrë nga ZRRE-ja.
2. Vendimet e ZRRE-së në lidhje me vazhdimin, modifikimin, pezullimin, ndërprerjen dhe transferin e licencës si dhe vendimet lidhur me gjobat si rezultat i shkeljeve të kushteve të licencës apo shkeljes së ligjeve të aplikueshme, mund të kontestohen nga i Licencuari në gjykatën kompetente sipas ligjeve në fuqi.

Neni 32
Hyrja në fuqi

1. Në pajtim me Nenin 32 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, kjo licencë, me numër licence **ZRRE/Li_03/17** i vazhdohet ndërmarrjes **"Ngrohtorja e Qytetit" Sh.A.** për aktivitetin e Shpërndarjes së Energjisë Termike dhe hyrë në fuqi me datë **19.11.2021**.
2. Licenca e lëshuar me datë **04 Tetor 2006**, (Nr. i Licencës **ERO/Li_03/06**), e modifikuar me **18.07.2012** (Nr. i Licencës **ZRRE/Li_03/12**), e modifikuar më **13.04.2017** (Nr. i Licencës **ZRRE/Li_03/17**) do të vazhdoj të jetë e vlefshme për një periudhë pesëmbëdhjetë (15) vjeçare, deri më **18 nentor 2036**.
3. Licenca do të jetë e vlefshme për periudhë kohore sipas paragrafit 1 të këtij neni, me mundësi vazhdimi, nëse i licencuari aplikon për vazhdim licence jo më vonë se gjashtë (6) muaj para skadimit të afatit të licencës dhe plotëson kushtet për vazhdim licence, në pajtim me Nenin 32 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, si dhe me dispozitat përkatëse të Rregullës për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë.
4. Obligohet ndërmarrja të sjell në Rregullator çdo dokument të lëshuar nga institucione të ndryshme për ndërmarrjen **"Ngrohtorja e Qytetit" Sh.A.** të cilët mund të kenë ndikim në validitetin dhe periudhën e vlefshmërisë së licencës së lëshuar, si dhe çdo dokument i cili mund të ndryshoj nga ai i sjellë gjatë aplikimit për marrje të licencës.

E vulosur me vulën e rëndomtë të Zyrës së Rregullatorit për Energji me datë: _____

Nënshkruar (në emër të Bordit të Rregullatorit) Kryesuesi Ymer Fejzullahu _____

Nënshkruar më: 19.11.2021

Fundi i dokumentit